

Përpunohen 3.2 milion ton mallra në 11 muaj

-124 mijë ton më shumë se vitin e kaluar-

Dt: 19 Dhjetor 2011

---



Në kalatat e portit detar të Durrësit gjatë 11 muajve të parë të këtij viti janë përpunuar më shumë se 3.2 milion mallra, 45 përqind e të cilave i përkasin eksporteve.

Nga statistikat e Autoritetit portual, mësohet se anijet dhe tragetet kanë transportuar rreth 124 mijë ton më shumë mallra se sa e njehta periudhë e vitit 2010.

Transporti me kontejnerë përmes portit më të madh të vendit thuajse ka arritur shifrën 1 milion ton, ndërsa numri i kontejnerëve të shfrytëzuar gjatë këtij 11-mujori ka arritur në 73.765 TEU (njësi kontejnerike).

Sipas të njejtave burime tragetet kanë transportuar më shumë se 667 mijë ton mallra, të ngarkuar në afro 60.800 kamjonë dhe trajlera.

Edhe shifrat e transportit të udhëtarëve me tragete janë më të larta se sa e njejtja periudhë e vitit 2010.

Që nga fillimi i këtij viti 773 mijë udhëtarë, 206 mijë prej të cilëve të huaj kanë preferuar të lundrojnë me tragetet e linjave që lidhin Durrësin me Barin, Ankonën dhe Triesten (Itali).

